REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 74/24
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 02.02.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13, nenin 58 pika “f”, nenin 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 43 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Z. **Raif Lahu,** nga Vushtrria, rruga “Lutfi Musiqi” nr.5, komuna Vushtrri, emërohet Drejtor Drejtorisë për Ekonomi dhe Investime Kapitale, në Vushtrri.

2. I emëruari nga pika 1 e këtij vendimi duhet të paraqitet në vendin e punës me datën 05.02.2024.
3. Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat në pozitën e emëruar do t’i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi, në Republikën e Kosovës si dhe urdhrave të Kryetarit të Komunës.

4. Drejtori i emëruar realizon pagë mujore në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

5. Zyrtari është i obliguar që ta bëjë deklarimin e pasurisë në AKK, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të pozitës.

6. Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVA

<u>Vendimi iu dërgohet:</u>
- Zyrës së personelit
- Raif Lahu
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 98/24
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 02.02.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe nenin 19 paragr. 1 të Rregullores (KKV) Nr. 08/2020, prot. 01nr.209/20, dt.29.10.2020 për Dhënien e Dekoratave, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDI M
## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR DEKORATA

1. Formohet komisioni për propozim të ndarjes së dekoratave brenda viti 2024, në këtë përbërje:
   1.1 **Albanez Tahiraj,** Drejtor për Arsim,
   1.2 **Medina Bunjaku,** Drejtore për Kulturë Rini dhe Sport
   1.3 **Hava Mlinaku,** Drejtore për Administratë
   1.4 **Blerim Ibrahimi,** përfaqësues i OJQ
   1.5 **Isak Hyseni,** përfaqësues i OJQ

2. Komisioni do të shqyrtoj të gjitha iniciativat gjegjësisht propozimet për ndarje të dekoratave të cilat duhet të jenë të arsyetuara me shkrim. Në rast se ju mungon arsyetimi kryesuesi i komisionit do të ia kthej propozuesit për të dhënë arsyetimin me shkrim.

3. Propozimet për dekorata për nderë të Ditës së Çlirimit bëhen kryesisht për ndarje të Mirënjohjeve, mirëpo mund të bëhen edhe për dekorata tjera.

4. Komisioni bënë përzgjedhjen paraprake dhe i propozon listën e ngushtë Kuvendit të Komunës për miratim. Kryesuesi i komisionit e arsyeton para anëtarëve të kuvendit listën e propozimeve.

5. Para përcaktimit të propozimeve për dekorata, komisioni do të verifikoj nga lista e dekoratave nëse ndonjëri nga të propozuarit iu është nda dekoratë në vitet paraprake. Në rast se në listë figuron emri i ndonjërit i cili ka marrë më herët dekoratë, ai nuk mund të propozohet për dekoratë të njejtë apo dekoratë më të ultë.

6. Komisioni do të filloj me punë me kohë në mënyrë që propozimet të dorëzohen në sekretari të KK-së brenda afatit të rregullt për mbledhjen e kuvendit të komunës.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVA

**Ferit Idrizi**
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 132/24
Nr. Fq. / Br. st
Data: / Datum 16.02.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Zyra e Kryetarit të Komunës

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. L-040, në bazë vendimit nr.22/178 të datës 13.12.2023 për themelimin e mekanizmit për paralajmërim të hershëm për Monitorimin dhe Trendët e Migrimit, Kryetari i Komunës, merr:

## VENDIM

1.Znj. Hyrie Uka Hoxha, caktohet person kontaktues për monitorimin dhe paralajmërimin e hershëm të trendit të migrimit dhe lëvizjes.

2.Qëllimi i funksionimit të MPHMTP, që ti mbështes institucionet përgjegjëse për menaxhimin e migrimit, pas liberalizimit të vizave në zonën Shengen.

3.Me qëllim që të grumbullohen më shumë të dhëna nga komuna për monitorimin e lëvizjes dhe migrimit, zyrtarja do të jetë pikë kontaktuese për mbledhjen e të dhënave lidhur me qytetarët e komunës së Vushtrrisë të cilët lëvizin në shtetet e zonës shengen.

4.Pas mbledhjes së të dhënave dhe informatave zyrtari përgjegjës , do të përgatit raportin dhe do ta përcjell te Udhëheqësi i Divizionit për Avancim të të Drejtave të Njeriut, i caktuar nga MPHMTM, në email adresën ejup.kamberaj@rks-gov.net.

5. Për zbatimin e vendimit do të përkujdeset kryetari i komunës.

6.Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe protokollimit.

Të dërgohet:
Hyrie Uka Hoxha
Sekretarisë së Komunës
MPHMTM

Kryetari i Komunës

Ferit Idrizi

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRRISË - REPUBLIKA KOSOVO - OPŠTINA VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 145/24
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 21.02.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Z. Naim Ferizi, udhëheqës i Sektorit në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, caktohet zyrtar përgjegjës në fushën e banimit social në Komunën e Vushtrrisë.

2. Zyrtari nga pika paraprake e këtij vendimi do të i ushtroj kompetencat dhe përgjegjësitë e tija në fushën e banimit social në Komunën e Vushtrrisë, konform legjislacionit në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVA II

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Njësisë së Personelit
- Z. Naim Ferizi
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 154/24
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 27.02.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV**

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
   1.1 z. **Albanez Tahiraj**, Kryesues i KO
   1.2 z. **Gëzim Saraçi,** anëtar
   1.3 z. **Izet Miftari**, anëtar
   1.4 znj. **Kadrije Meniqi,** anëtare
   1.5 z. **Urim Qirezi**, anëtar
   1.6 z. **Saim Bivolaku**, anëtar
   1.7 z.nj. **Edona Shotani**, anëtare
   1.8 z.**Astrit Izmaku,** anëtar

2. Këshilli organizativ do të ndërmerr me kohë të gjitha veprimet e nevojshme për organizim të shënimit në mënyrë sa më solemne të kësaj date të rëndësishme.

3. Kryesuesi i KO do të raportoj te kryetari i komunës lidhur me përgatitjet për këtë manifestim si dhe mbarëvajtjen, pas përfundimit të shënimit të kësaj date.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË
REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA VUČITRN

**Ferit Idrizi**

**Kryetar i Komunës**

Vendimi i dërgohet:
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.